



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:256255
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05476357

Ac.nr.5559/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Nora Billaca Dula dhe Fatmir Baloku anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. S. nga Mitrovica, të cilin me autorizim e përfaqëson Avdyl Hyseni, avokat me seli në rr. ‘L. H.’, H-100, nr.13-1, në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore nga Ministria e Drejtësisë, me avokatin shtetëror Bedri Krasniqi, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.8871/2021, të datës 31.05.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.8871/2021, i datës 31.05.2023, në pikën I (një) dhe II (dy), VËRTETOHET.

II. Pika III (tre) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.8871/2021, të datës 31.05.2023, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.8871/2021, i datës 31.05.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET E BAZUAR pjesërisht kërkesëpadia e paditësit M. S. nga Mitrovica. II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësit në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, dhe 2020, t’ia paguaj për çdo vit

shumën nga 585.62 euro, e në total, shumën prej 1,756.86 euro me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 16.11.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë Gjykatë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. III. REFUZOHET E PABAZUAR pjesa e kërkesëpadisë së paditësit me të cilën ka kërkuar “të DETYROHET e paditura që në emër të shpërblimit për ushqimin ditor (shujtave ditore) nga 3 euro për ditë pune, për periudhën nga data 14.11.2018 deri me datën 09.11.2021, respektivisht për 661 ditë pune të paguajë paditësit shumën prej 1,983.00 euro”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura përmes të autorizuarit së saj, brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën e paraqitur si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar apo ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë. Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se paditësi të ketë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M. S. nga Mitrovica, përmes të autorizuarit të tij, me datë 16.11.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e shpërblimit për pagë të trembëdhjetë dhe shujtave ditore (me detaje të tjera si në petitumin e padisë). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.8871/2021, të datës 31.05.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka arsyetuar se “ nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton fakti se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës që nga data 15.04.2013. Ndërsa përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës 07/1-01SAP-P/9664, të datës 08.11.2021, është vërtetuar fakti se paditësi për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 585.62 € për një muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2018, 2019 dhe 2020 gjykata vërtetoi faktin se paditësja për këto vite ka pasur vlerësim të përgjithshëm, me notën 4, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm. Për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, bazuar në faktet dhe provat e paraqitura, kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e

Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Më tutje ka theksuar se nga faktet dhe provat e paraqitura, kjo gjykatë vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj t'ia paguaj pagën e 13-të për çdo fund vit pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit, kjo pasi që vlerësimi për vitet 2018, 2019 dhe 2020 nga ana e të paditurës ka qenë plotësisht i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019 dhe 2020, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga i cili rezultojnë pagat të cilat i realizon paditësi, andaj për vitet 2018, 2019 dhe 2020, i takojnë shumat ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo gjykatë duke vlerësuar se nga një raport i tillë paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura rolin e debitorit, referuar nenit 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditëses si në shumat e cekuar në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit, me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, është vendosur që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoi shumat e gjykuara. Ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë ku paditësi ka kërkuar në emër të shpërblimit për ushqimin ditor (shujtave ditore) nga 3 euro për ditë pune, për periudhën nga data 14.11.2018 deri me datën 09.11.2021, respektivisht për 661 ditë pune t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,983.00 euro, vendosi që jashtë seancë këtë pjesë të kërkesëpadisë ta refuzoj, kjo pasi që paditësi nuk ka arritur që të provojë se këtu me të paditurën si punëdhënëse kanë raporte kontraktuale ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës për paditësin për kompensimin e shujtave ditore.

Lidhur me bazën ligjore është bazuar në nenin 5, paragrafi 2, nenit 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës lidhur me nenin 55 të Ligjit të Punës dhe nenit 44 dhe 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit për Policinë e Kosovës .

Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe për shpenzimet në bazë të nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet e palës së paditur lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe i njëjti ka performancë të kënaqshme në punë dhe kjo sipas formularëve për vlerësim të performancës nga të cilat rezulton se paditësi ka pasur performancë shumë të mirë për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45, Udhëzimit Administrativ nr.4/2017 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht të nenit 29 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13 kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar kërkesë padinë e paditësve dhe detyruar të paditurën që të njëjtëve t'ua shpërblejë (kompensojë) pagat e trembëdhjeta, për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'i paguajë shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit të pagave të 13, me të drejtë është bazuar Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht të nenit 29. Paragrafi 2, i cili përcakton të drejtën për pagën e 13 kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm. Këtë çështje e ka sqaruar edhe Gjykata Supreme e Kosovës përmes Mendimit Juridik GJ.A.nr.213/2023, datë 09.10.2023, në pikën II të tij.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për Buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Gjykata e Apelit të Kosovës, vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi pasi që për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit si në pikën III të aktgjykimit të ankimuar me ankesë nuk kishte pretendime ankimore nga e paditura.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së dhe me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5559/2023 datë 18.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj